

VENDIM
Nr. 876, datë 18.12.2019

PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR. 187, DATË 8.3.2017, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË
PAGAVE TË NËPUNËSVE CIVILË/NËPUNËSVE, ZËVENDËSMINISTRIT DHE
NËPUNËSVE TË KABINETEVE NË DISA INSTITUCIONE TË
ADMINISTRATËS PUBLIKE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, strukturat dhe shpërblimet e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 187, datë 8.3.2017, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen shtesat, me këtë përmbajtje:

a) Në fund të pikës 1/1 shtohet emërtesa “Prokuroria e Posaçme”.

b) Pas pikës 7/2 shtohet pika 7/3, me këtë përmbajtje:

“7/3 Nivelet e pagave për funksionarët e kabinetit në Prokurorinë e Posaçme janë sipas lidhjes nr. 4/3/a, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve në Prokurorinë e Posaçme janë sipas lidhjes nr. 4/3/b, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2019, të përballohen nga fondet e miratuara për Prokurorinë e Posaçme dhe të fillojnë nga momenti i transferimit apo i emërimit të funksionarëve dhe të nëpunësve.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Lidhja nr. 4/3/a

NIVELET E PAGAVE PËR FUNKSIONARËT E KABINETIT
NË PROKURORINË E POSAÇME

POZICIONI	KATEGORIA	KRITERI MINIMAL I DIPLOMËS SË SHKOLLËS SË LARTË PËR EFEKT TË PRANIMIT NË POZICIONIN PÛRKATËS TË PUNËS PAGA E GRUPIT
Këshilltar në kabinetin e drejtuesit të Prokurorisë	I-b	1
Sekretar i drejtuesit të Prokurorisë	Barazohet në pagë me sekretarin e Kryeministrit	

Lidhja nr. 4/3/b

KATEGORITË E PAGAVE TË POZICIONEVE TË PUNËS SË NËPUNËSVE
NË PROKURORINË E POSAÇME

POZICIONI	KATEGORIA	KRITERI MINIMAL I DIPLOMËS SË SHKOLLËS SË LARTË PËR EFEKT TË PRANIMIT NË POZICIONIN PËRKATËS TË PUNËS PAGA E GRUPIT
Kancelar	I-a	1
Drejtore drejtorie Ekspert	II-b	1
Përgjegjës sektori	III-a	1
	III-a/1	
Specialist	III-b	1 ose 2
Specialist	IV-a	1 ose 2, ose 3
	IV-b	